



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËS SH.A

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi Kolektoreve të KUZ në Qytetin
e Kukësit, Bashkia Kukës”.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 Muaj .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(CPV): 45000000-7 – Punë ndërtimi

(CPV): 45232410-9 Punime në Kanalizime .

VLERA E FONDIT LIMIT: 100 013 185 *(njqind milion e trembedhjete mijë e njqind e tetedhjete e pese) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2026 në vlerën: 20 002 915 (njqzet milion e dy mijë e nentqind e pesembedhjete) lekë pa TVSH, për vitin 2027 në vlerën: 30 004 317 (tridhjete milion e kater mijë e treqind e shtatembedhjete) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2028 në vlerën: 50 005 953 (pesedhjete milion e pese mijë e nentqind e pesedhjete e tre) lekë pa TVSH.*

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit.**

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjdhjes së fituesit ka përgjdhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periodha e garancisë së objektit ☐	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 12 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

***Shënim:** Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink2a} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk2a} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënesi të mëparshëm ose përfituesit.

b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë të ndërrimit të strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin

Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifkohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të percaktuar ofertën ekonomike më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikon e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksess të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetëm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me përvojën e duhur mund të siellë rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventiv të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencë në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që në veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër te tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet ti kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura ne projekt gjate realizimit te tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe te detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhenë Propozime konkrete se si do te ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor ben vleresimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nenkrteret për operatoret ekonomike pjesëmarrës ne këtë rast dhe që do te vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor, do të ienë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Perdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si nje iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomkisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkrteret e mësipërme.

Një rëndësi e vecantë i është dhen edhe Periudhes së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e obijektit, faktin se sa me maksimale te ietë periudha aë perfshin garancina e vepres e deklaruar nga operatori ekonomik pjesemarrës, aq me tepër autoriteti kontraktor bindet per angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qellimin final realizimin perfundimtar te vepres dhe marrien në dorëzim te saj.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

1. Pervoja e suksesshme me kontrata e mepareshme kerkuar sipas pikes 2.3.1 te kapacitetit teknik te KVK
2. Licensa profesionale sipas niveleve per cdo kategori punimesh kerkuar sipas pikes 2.3.2 germa a) dhe b)
3. Stafi inxhenjerik (drejtues teknik) sipas pikes 2.3.3 germa a), b) dhe c)
4. Xhiron vjetore gjate tre viteve te fundit financiare si dhe bilancet e kerkuar sipas pikes 2.2.1, 2.2.2
5. Licensa III.2.b kerkuar sipas pikes 2.3.4

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetet në faktin se:

- Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.
- Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të

garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 16 datë 08.02.2024 Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës – Kanalizimeve, Kukës Sh.a, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.*

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikës 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim).

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**; ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomikë dhe financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligji Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në keto kushte, vlerësojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

*Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet jane kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese Kontratën e Sipërmarrjes; formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situcion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme

janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kerkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

*Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”*

2.3.2 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Per punimet e pergjithshme te ndertimit:

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime gërmimi në tokë | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 4 Rruge, autostrada, ura, mbikalime... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit | Klasifikimi A |

Per punimet speciale te ndertimit:

- | | |
|--|----------------------|
| • Kategoria NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi A |

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e liçencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që

ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënllorit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 dhe nenit 78 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të përcaktojë kriteret kualifikimi që lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, janë proporcionale me të dhe të nevojshme për realizimin me sukses të punimeve.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi duhet të disponojnë licencat përkatëse sipas natyrës së punimeve që do të kryhen.

Për këtë arsye është kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë kategoritë e mëposhtme të licencës:

Kategoria NP-1 “Punime gjërmimi në tokë” – Klasifikimi A

Kjo kategori është e domosdoshme pasi preventivi përfshin volume të konsiderueshme gjërmimesh dhe punimesh dheu, konkretisht: Gjërmim kanalesh në tokë të zakonshme – 1,586.90 m³; Gjërmim dheu me ekskavator në kanale – 2,590.30 m³; Gjërmime me mbrojtje “Trench Box” për gjatësi totale mbi 3,100 ml; Gjërmim me mikrotunel me drejtim lazer; Mbushje dhe ngjeshje të kanaleve pas vendosjes së tubacioneve.

Këto zëra përbëjnë bazën kryesore të ndërhyrjes infrastrukturore dhe kërkojnë operatorë të licencuar për kryerjen e punimeve të gjërmimit dhe stabilizimit të terrenit sipas legjislacionit të ndërtimit.

Kategoria NP-4 “Rrugë, autostrada, ura, mbikalime” – Klasifikimi A

Kërkimi i kësaj licence lidhet me faktin se rehabilitimi i kolektorëve kryhet brenda trupit të rrugëve urbane ekzistuese dhe kërkon rikthimin e tyre në gjendjen fillestare pas ndërhyrjes.

Preventivi përfshin: Prerje asfalti me disk – 950 ml; Shtresë çakëlli me cilindrim – 1,651 m²; Shtresë stabilizanti – 2,110.60 m²; Shtresë binderi – 1,651 m²; Shtresë asfaltobetoni – 4,980 m²; Prishje trotuari ekzistues; Ndërtim trotuari me pllaka; Vendosje bordurash betoni.

Këto janë tipike punime rrugore dhe rikonstruksioni të infrastrukturës rrugore, për të cilat legjislacioni i licencimit kërkon disponimin e kategorisë NP-4.

Kategoria NP-7 “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje” – Klasifikimi C

Objekti i prokurimit konsiston pikërisht në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza (K.U.Z.), duke e bërë këtë kategorinë kryesore të licencës së nevojshme.

Preventivi përfshin: Vendosjen e tubacioneve HDPE DN/OD 250 mm, 315 mm, 400 mm, 500 mm dhe 630 mm; Pastrimin e tubacioneve ekzistuese të kanalizimeve; Pastrimin e 130 pusetave ekzistuese; Ndërtimin dhe rehabilitimin e strukturave të kanalizimeve; Punime drenazhimi, mbushjeje dhe sistemimi të kanaleve.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të tubacioneve dhe natyrës së veçantë hidroteknike të punimeve, kërkesa për kategorinë NP-7 në klasifikimin C është proporcionalisht e lidhur me objektin e kontratës.

Kategoria NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” – Klasifikimi A

Punimet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve urbane, duke synuar reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza.

Rehabilitimi i kolektorëve të K.U.Z. përbën një vepër tipike të inxhinierisë mjedisore, pasi lidhet me: Menaxhimin e ujërave të ndotura; Parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave; Përmirësimin e kushteve sanitare dhe mjedisore të zonës urbane.

Për këtë arsye, kërkimi i kategorisë NP-12 është në përputhje me natyrën e investimit.

Kategoria NS-1 “Punime për prishjen e ndërtimeve” – Klasifikimi A

Preventivi parashikon punime të ndryshme prishjeje, ndër të cilat: Prishje trotuari ekzistues; Prishje bordurash betoni; Prerje dhe hapje të shtresave asfaltike ekzistuese; Heqje të elementëve ekzistues të infrastrukturës rrugore.

Kryerja e këtyre punimeve kërkon njohuri teknike dhe mjete të specializuara për prishje, ndaj kërkit i kategorisë NS-1 është i nevojshëm dhe proporcional.

Kategoria NS-18 “Punime topogjeodezike” – Klasifikimi A

Objekti përfshin ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjeteve nëntokësore të kanalizimeve përgjatë rrugëve urbane, ku saktësia e pozicionimit është element thelbësor për realizimin korrekt të punimeve.

Punimet kërkojnë: Piketime topografike të akseve të kolektorëve; Matje të kuotave dhe pjerrësive hidraulike; Kontroll të koordinatave gjatë vendosjes së tubacioneve; Hartim të matjeve për situacionet dhe kolaudimin e punimeve.

Për shkak të karakterit linear të rrjetit të kanalizimeve dhe kërkesave teknike për vendosjen e tubacioneve sipas kuotave projektuese, kërkit i licencës NS-18 është i domosdoshëm për realizimin korrekt të kontratës.

b) Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin **Certifikatat si më poshtë, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:**

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do **Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹”** në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: ***aftësinë teknike dhe profesionale***;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë ***se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike***, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285

datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Çertifikatë ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune”, ose certifikatë me standartin e përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023** mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës,

zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj. Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar minimalisht **40 (dyzet)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë të punësuar minimalisht 40 (dyzet) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit para datës së hapjes së procedurës së prokurimit.

Ky kriter është vendosur në funksion të garantimit të kapaciteteve të nevojshme njerëzore për realizimin brenda afateve dhe sipas standardeve teknike të objektit të prokurimit “Rehabilitimi i Kolektorëve të K.U.Z. në Qytetin e Kukësit”, duke qenë se preventivi parashikon një volum të konsiderueshëm punimesh ndërtimore, gërmimi, transporti, montimi dhe rikonstruksioni të infrastrukturës rrugore.

Nga analiza e zërave të preventivit rezulton se objekti përfshin: Gërmime kanalesh dhe gërmime mekanike në vëllimin rreth 4,177 m³; Gërmime me sistem mbrojtës “Trench Box” në një gjatësi totale prej 3,111 ml; Mbushje me gur kave në sasinë 3,809.40 m³; Transport materialesh dhe dherash në sasinë 7,089.20 m³; Vendosje tubacionesh HDPE në diametra të ndryshëm me gjatësi totale rreth 1,346 ml; Pastrim të rrjetit ekzistues të kanalizimeve në gjatësi 1,160 ml; Pastrim të 130 pusetave ekzistuese; Ndërtim strukturash betoni dhe betonarmeje në sasinë 417.20 m³; Punime asfaltimi dhe rikonstruksioni rrugor në sipërfaqe mbi 6,600 m²; Punime trotuari, bordurash, stabilizanti dhe shtresash rrugore.

Për realizimin e këtyre proceseve të punës kërkohet angazhimi paralel i disa grupeve të punës, konkretisht: Ekipi i gërmimeve dhe sistemit të kanaleve; Ekipi për montimin e tubacioneve dhe elementëve të rrjetit; Ekipi për realizimin e strukturave të betonit dhe betonarmesë; Ekipi për mbushjet, ngjeshjet dhe shtresat rrugore; Ekipi për asfaltimin dhe rikonstruksionin e trotuareve; Ekipi për pastrimin e rrjetit ekzistues dhe pusetave; Drejtuesit e mjeteve, operatorët e makinerive të rënda dhe personeli ndihmës.

Bazuar në natyrën e punimeve, volumin e konsiderueshëm të preventivit dhe nevojën për zhvillimin e proceseve të punës në disa fronte njëkohësisht, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i minimalisht 40 punonjësve përbën një kërkesë proporcionale, të arsyeshme dhe të lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Kjo kërkesë nuk tejkalon nevojat reale të kontratës, por synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitete të mjaftueshme organizative dhe njerëzore për të përballuar volumin e punimeve të parashikuara në preventiv, për të respektuar afatet e zbatimit dhe për të garantuar cilësinë e punimeve sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.

Kërkesa për minimumi 40 punonjës është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 41 të VKM nr.285/2021, pasi lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe është proporcionale me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara në preventiv.

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:**

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder

Për të stafit inxhinierik drejtues teknik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.*

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Inxhinier Mjedis 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit referuar Udhëzimit nr.2 date 13.05.2005).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

- e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Staf teknik

- Teknik Ndërtimi 1(një)
- Teknik Topograf 1(një)
- Teknik Saldator 1(një)
- Hidraulikë 2 (dy)

- Betonues 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Punonjes asfalti 2 (dy)
- Mekanik 1 (një)
- Shofer 2 (dy)
- Punëtorë të thjeshtë 5 (pesë)

Punonjës Manovrator

- Eskavatorist 2 (dy)
- Automakinist 1 (një)
- Buldezorist 1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Për puntoret e thjeshte te paraqitet Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm automakinist/eskavatorist duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

(Në rastin kur punonjësit shofer, eskavatorist, buldezorist, automakinist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

- f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi/certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:
- Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
1 (një) punonjës me certifikatë **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 40 punonjës përfshin punëtorë të thjeshtë, staf i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë, person specializuar/të kualifikuar. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve të punës dhe grafikut të punimeve.

Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerve/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39, nenit 41 dhe nenit 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar stafin teknik, inxhinierik dhe mbështetës duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e preventivit dhe afatin 12 (dymbëdhjetë) mujor të realizimit të kontratës.

Objekti "Rehabilitimi i Kolektorëve të K.U.Z në Qytetin e Kukësit" përfshin punime të shpërndara në disa akse rrugore urbane, të cilat do të realizohen në faza të ndryshme përgjatë periudhës kontraktuale 12-mujore. Preventivi parashikon volume të konsiderueshme punimesh, konkretisht: Gërmim kanalesh dhe gërmime mekanike në vëllim mbi 4,100 m³; Gërmime me mbrojtje metalike "Trench Box" në gjatësi totale 3,111 ml; Mbushje me gur kave 3,809.40 m³; Transport materialesh dhe dherash 7,089.20 m³; Vendosije tubacionesh HDPE DN 250 mm, 315 mm, 400 mm, 500 mm dhe 630 mm në gjatësi totale mbi 1,300 ml; Pastrim kolektorësh ekzistues

1,160 ml;Pastrim i 130 pusetave ekzistuese;Ndërtim strukturash betoni dhe betonarmeje 417.20 m³;Shtresa çakëlli 1,651 m²;Shtresa stabilizanti 2,110.60 m²;Binder 1,651 m²;Asfaltobeton 4,980 m²;Prishje trotuareve, bordurave dhe rikonstruksion i elementeve rrugore.

Duke qenë se punimet do të realizohen në një periudhë 12-mujore dhe në disa fronte pune njëkohësisht, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme disponimin e personelit të mëposhtëm.

STAFI DREJTUES TEKNIK

Inxhinier Ndërtimi – 1 (një)

Ky profil kërkohet për mbikëqyrjen e vazhdueshme të:Gërmimeve dhe sistemimit të kanaleve; Punimeve të betonit dhe betonarmesë;Mbushjeve dhe ngjeshjeve; Punimeve të shtresave rrugore;Rikonstruksionit të trotuareve dhe bordurave.

Gjatë gjithë periudhës 12-mujore të kontratës, ky inxhinier do të koordinojë aktivitetet ndërtimore në të gjitha fazat e zbatimit, duke garantuar respektimin e projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve të ndërtimit.

Inxhinier Hidroteknik – 1 (një)

Objekti lidhet drejtpërdrejt me rehabilitimin e kolektorëve të kanalizimeve të ujërave të zeza.

Ky specialist është i nevojshëm gjatë gjithë afatit kontraktual për: Kontrollin e kuotave hidraulike;Verifikimin e pjerrësive të rrjedhjes; Vendosjen e tubacioneve HDPE; Rakordimin me rrjetin ekzistues;Testimin dhe funksionalizimin e sistemit.

Për shkak se zërat kryesorë të preventivit lidhen me tubacionet dhe kolektorët e kanalizimeve, prania e vazhdueshme e këtij profili është e domosdoshme.

Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder – 1 (një)

Punimet përfshijnë rrjete lineare nëntokësore me gjatësi të konsiderueshme dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm topografik.

Ky inxhinier është i nevojshëm për:Piketimin e akseve të kolektorëve;Kontrollin e kuotave të gërmimeve;Verifikimin e pozicionimit të tubacioneve;Matjet për situacionet mujore;Hartimin e dokumentacionit përfundimtar të objektit.

Nevoja për këtë profil ekziston gjatë gjithë periudhës së zbatimit dhe jo vetëm në fazën fillestare të punimeve.

STAFI INXHINIERIK MBËSHTETËS

Inxhinier Mjedisi – 1 (një)

Punimet zhvillohen në një rrjet ekzistues kanalizimesh dhe përfshijnë:Pastrim të kolektorëve;Pastrim pusetash;Menaxhim të materialeve të nxjerra nga gërmimet;Punime me ndikim në mjedisin urban.

Ky inxhinier monitoron zbatimin e masave mjedisore gjatë gjithë periudhës 12-mujore të kontratës.

STAFI TEKNIK I ZBATIMIT

Teknik Ndërtimi – 1 (një)

Nevojitet për ndjekjen ditore të proceseve të gërmimit, betonimit, mbushjeve dhe rikonstruksionit të shtresave rrugore.

Teknik Topograf – 1 (një)

Asiston Inxhinierin Gjeodet në matjet e vazhdueshme dhe kontrollin e kuotave përgjatë gjithë gjurmës së punimeve.

Teknik Saldator – 1 (një)

Kërkohet për proceset e lidhjes dhe montimit të elementeve të rrjetit HDPE dhe ndërhyrjeve në strukturat metalike të nevojshme gjatë zbatimit.

Hidraulikë – 2 (dy)

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të tubacioneve HDPE dhe numrit të lidhjeve me rrjetin ekzistues, nevojiten dy ekiye pune për montimin dhe rakordimin e sistemit.

Betonues – 2 (dy)

Preventivi parashikon realizimin e 417.20 m³ strukturë betoni dhe betonarmeje, si dhe elemente ndihmëse të rrjetit, duke justifikuar nevojën për betonues të specializuar.

Karpentierë – 2 (dy)

Nevojiten për realizimin e kallëpeve të strukturave të betonit, pusetave dhe elementeve konstruktive gjatë gjithë periudhës së betonimeve.

Hekurkthyes – 2 (dy)

Kërkohen për përgatitjen dhe montimin e armaturave të betonit për strukturat betonarme që parashikon preventivi.

Punonjës Asfalti – 2 (dy)

Preventivi përfshin: Binder 1,651 m²; Asfaltobeton 4,980 m²; Rikonstruksion të sipërfaqeve rrugore pas mbylljes së kanaleve.

Këto procese kërkojnë staf të specializuar për asfaltim dhe rikthimin e infrastrukturës rrugore në gjendjen fillestare.

Mekanik – 1 (një)

Përgjatë 12 muajve do të përdoren ekskavatorë, kamionë, mjete transporti dhe pajisje të tjera mekanike, të cilat kërkojnë mirëmbajtje dhe asistencë teknike të vazhdueshme.

Shoferë – 2 (dy)

Volumi prej 7,089.20 m³ transport materialesh dhe dherash justifikon nevojën për shoferë të dedikuar për lëvizjen e materialeve dhe mbështetjen logjistike të kantierit.

Punëtorë të thjeshtë – 5 (pesë)

Kërkohen për mbështetjen e proceseve të gërmimit, montimit të tubacioneve, mbushjeve, pastrimit të rrjetit dhe sistemimit të kantierit.

IMANOVRATORËT E MAKINERIVE

Eskavatoristë – 2 (dy)

Punimet e gërmimit dhe hapjes së kanaleve në vëllim mbi 4,100 m³ si dhe gërmimet me Trench Box kërkojnë përdorimin paralel të ekskavatorëve në disa fronte pune.

Automakinistë – 1 (një)

Kërkohen për operimin e mjeteve transportuese dhe makinerive ndihmëse gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Buldezorist – 1 (një)

Nevojitet për sistemimin e terrenit, shpërndarjen e materialeve mbushëse dhe formimin e shtresave rrugore.

STAFI I SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë – 1 (një)

Punimet përfshijnë: Gërmime në thellësi; Punime në kanale dhe kolektorë; Operim makinerish të rënda; Punime betonimi dhe asfaltimi; Punime në rrjet kanalizimesh.

Për rrjedhojë, prania e këtij specialisti është e nevojshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës për garantimin e sigurisë së punëmarrësve.

Në zbatim të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për sigurinë në kantier”, prania e një personi të certifikuar për sigurinë në punë është e detyrueshme.

Mjek i Shoqërisë ose i Kontraktuar

Duke marrë në konsideratë numrin e personelit të angazhuar, kohëzgjatjen 12-mujore të kontratës dhe karakterin e punimeve me risk të shtuar, mbulimi mjekësor është i domosdoshëm për përmbushjen e kërkesave të legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përfundimisht, numri dhe profilet e personelit të kërkuar janë përcaktuar mbi bazën e volumeve konkrete të preventivit, natyrës së punimeve të kanalizimeve, punimeve civile dhe rrugore, si dhe afatit 12-mujor të realizimit të kontratës, duke qenë të domosdoshme për zhvillimin paralel të proceseve të punës, respektimin e grafikut të zbatimit dhe realizimin me cilësi të objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, si dhe legjislacionit mjedisor në fuqi për administrimin e mbetjeve, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte”.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, volumin e konsiderueshëm të materialeve që do të gjenerohen gjatë zbatimit të kontratës dhe detyrimin ligjor për administrimin e mbetjeve që krijohen nga aktiviteti ndërtimor. Kodi III.2.B mbulon veprimtaritë e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte të krijuara gjatë proceseve të ndërtimit dhe rehabilitimit.

Nga analiza e preventivit të objektit “Rehabilitimi i Kolektorëve të K.U.Z në Qytetin e Kukësit”, rezulton se gjatë zbatimit të punimeve do të krijohen sasi të konsiderueshme dherash, asfalti të prishur, beton i prishur, bordura ekzistuese, materiale gjurmimi dhe mbetje të tjera inerte

Disponimi i licencës QKL Kodi III.2.B nuk përbën një kërkesë të shkëputur nga objekti i kontratës, por lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë gjurmime, prishje, transport dhe largim të materialeve të dala nga punimet. Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin profesional për të administruar mbetjet inerte të gjeneruara gjatë zbatimit të kontratës, në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe kërkesat e zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për licencën QKL Kodi III.2.B është në përputhje të drejtë me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe është e nevojshme për realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore në fuqi.

2.3.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht si më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Pronesi ose me qira	2 copë
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10-15 ton	Pronesi ose me qira	2 copë

3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	Pronesi ose me qira	1 copë
4	Eskavator me goma 0.25m3	Pronesi ose me qira	1 copë
5	Ekskavator me zinxhire	Pronesi ose me qira	1 copë
6	Minieskavator	Pronesi ose me qira	1 copë
7	Minifadrome me targa	Pronesi ose me qira	1 copë
8	Rimorkiator per transport mjetesh te renda	Pronesi ose me qira	1 copë
9	Rrul (kompresor me vibrim) {Hekur/Gome}	Pronesi ose me qira	1 copë
10	Rrul hekur hekur	Pronesi ose me qira	1 copë
11	Grejder	Pronesi ose me qira	1 copë
12	Autobetonierë	Pronesi ose me qira	2 copë
13	Autovinç 5 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
14	Autobot	Pronesi ose me qira	1 copë
15	Autobote teknologjike e paisur me pompe vakumi dhe me pompe presioni. paisur me sonda teknologjike	Pronesi ose me qira	1 copë
16	Autobote teknologjike i paisur me pompe vakumi dhe me pompe presioni te larte	Pronesi ose me qira	1 copë
17	Minidumper pesha mbajtese 2 - 5 ton (MT) me targa	Pronesi ose me qira	1 copë
18	Makine per shpime horizontale te drejtuara (HDD) për mikrotunele	Pronesi ose me qira	1 copë
19	Autobitumatriçe	Pronesi ose me qira	1 copë
20	Asfaltoshtruese	Pronesi ose me qira	1 copë
21	Prerëse /sharrë Asfalti	Pronesi ose me qira	1 copë
22	Vibrator	Pronesi ose me qira	1 copë
23	Tokmak elektrik	Pronesi ose me qira	1 copë
24	Matrapik	Pronesi ose me qira	1 copë
25	Gjenerator	Pronesi ose me qira	1 copë
26	Kontenier për zyrë stacionere	Pronesi ose me qira	1 copë
27	Aparaturë për bashkim tubacionesh	Pronesi ose me qira	1 copë

28	Batipal manual per montim panelesh metalik	Pronesi ose me qira	2 copë
29	Mjet për batipal	Pronesi ose me qira	1 copë

- Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

Nr	Mjete mbrojtese	Njesia	Sasia
1	Kuti e ndihmes se shpejte	cope	5 copë
2	Tabela sinjalistike e perkohshme per menaxhim trafiku	cope	10 copë
3	Helmata pune, kokore	cope	40 copë
5	Fikëse zjarri të lëvizshme	cope	3 copë

- Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme.

Për mjetet me qera, të paraqiten dokumentet e mesiperme që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme dhe keto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shitblerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme. Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e qerasë për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Shënim: Për mjetin “Rimorkiator për transportin e makinerive”, në rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni çertifikate pronësie / kontratë qeraje, nga autoriteti kontraktor do të pranohet edhe dokumenti kontratë huapërdorje.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit

publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 39 dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës "Rehabilitimi i Kolektorëve të K.U.Z në Qytetin e Kukësit", duke u bazuar në natyrën e punimeve, volumet e preventivit, afatin 12-mujor të realizimit dhe nevojën për zhvillimin paralel të proceseve të punës në disa fronte.

Objekti përfshin ndër të tjera: Gërmime kanalesh dhe gërmime mekanike mbi 4,177 m³; Gërmime me mbrojtje "Trench Box" në gjatësi 3,111 ml; Mbushje me gur kave 3,809.40 m³; Transport materialeve dhe dherash 7,089.20 m³; Vendosje tubacionesh HDPE DN 250–630 mm; Pastrim kolektorësh 1,160 ml; Pastrim të 130 pusëve ekzistuese; Strukturë betoni dhe betonarmeje 417.20 m³; Punime asfaltimi mbi 6,600 m²; Punime mikrotuneli me drejtim lazer.

I. MAKINERITË E TRANSPORTIT

1. Kamiona vetëshkarkues mbi 20 ton – 2 copë

Kërkohen për transportin e sasive të konsiderueshme të materialeve të gërmimit, mbushjeve dhe materialeve ndërtimore. Duke qenë se preventivi parashikon transport të materialeve dhe dherave në sasinë 7,089.20 m³, disponimi i dy mjeteve me kapacitet të lartë është i domosdoshëm për garantimin e ritmit të punimeve dhe respektimin e afatit 12-mujor.

2. Kamion vetëshkarkues 10–15 ton – 2 copë

Nevojiten për transport të vazhdueshëm të materialeve mbushëse, agregateve, çakëllit dhe materialeve asfaltike në zonat urbane ku mjetet e tonazhit të lartë mund të kenë kufizime operimi.

3. Kamion vetëshkarkues 5–10 ton – 1 copë

Kërkohet për furnizime të pjesshme, transport materialeve në rrugë me akses të kufizuar dhe mbështetje logjistike të fronteve të vogla të punës.

II. MAKINERITË E GËRMIMIT

4. Eskavator me goma 0.25 m³ – 1 copë

Lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit:

- Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³ në sasinë 2,590.30 m³.

Ky mjet është specifikisht i parashikuar në preventiv dhe është i domosdoshëm për hapjen e kanaleve në mjedise urbane.

5. Eskavator me zinxhir – 1 copë

Kërkohet për gërmimet me thellësi më të mëdha, punimet në terrene të vështira dhe manovrimin e sistemeve Trench Box përgjatë gjurmës së kolektorëve.

6. Minieskavator – 1 copë

Nevojitet për ndërhyrje në rrugë të ngushta, afër ndërtesave dhe në zona ku ekskavatorët standardë nuk mund të operojnë.

7. Minifadromë me targa – 1 copë

Kërkohet për ngarkimin e materialeve, sistemimin e mbushjeve dhe pastrimin e vazhdueshëm të kantierit.

MAKINERITË E TRANSPORTIT TË PAJISJEVE

8. Rimorkiator për transport mjeteve të rënda – 1 copë

Objekti zhvillohet në disa akse rrugore të ndryshme dhe kërkon zhvendosjen e vazhdueshme të makinerive ndërmjet fronteve të punës.

MAKINERITË E NGJESHJES DHE SISTEMIMIT

9. Rrul me vibrim (hekur/gomë) – 1 copë

Lidhet me:

- Mbushjet e kanaleve;
- Shtresën e çakëllit 1,651 m²;
- Stabilizantin 2,110.60 m².

Kërkohet për arritjen e parametrave të ngjeshjes sipas specifikimeve teknike.

10. Rrul hekur-hekur – 1 copë

Kërkohet për ngjeshjen e shtresave asfaltike dhe realizimin e parametrave të kërkuar të asfaltimit.

11. Grejder – 1 copë

Nevojitet për profilimin e sipërfaqeve dhe formimin e shtresave rrugore para asfaltimit.

V. MAKINERITË E BETONIT

12. Autobetonierë – 2 copë

Preventivi përfshin:

- Strukturë betoni dhe betonarmeje C20/25 në sasinë 417.20 m³;
- Shtresë betoni C16/20 në sasinë 45.96 m³.

Për realizimin e këtyre volumeve kërkohen autobetonierë që garantojnë furnizim të pandërprerë me beton.

13. Autovinç 5 ton – 1 copë

Kërkohet për montimin e paneleve Trench Box, ngritjen e materialeve të rënda, pusetave dhe elementeve prefabrikate.

MAKINERITË E SHËRBIMIT TË RRJETIT K.U.Z.

14. Autobot – 1 copë

Nevojitet për furnizimin me ujë gjatë punimeve të ngjeshjes dhe kontrollit të pluhurave në kantier.

15. Autobot teknologjik me pompë vakumi dhe presioni – 1 copë

16. Autobot teknologjik me pompë vakumi dhe presioni të lartë – 1 copë

Këto mjete lidhen drejtpërdrejt me zërat:

- Pastrim tubi kanalizimesh 1,160 ml;
- Pastrim pusetash ekzistuese 130 copë.

Pa këto mjete nuk mund të realizohen punimet e pastrimit të rrjetit ekzistues të kanalizimeve.

MAKINERITË SPECIALE TË OBJEKTIT

17. Minidumper 2–5 ton – 1 copë

Kërkohet për transport materialesh në zona me akses të kufizuar dhe brenda kantierit.

18. Makinë për shpime horizontale të drejtuara (HDD) – 1 copë

Lidhet drejtpërdrejt me zërin:

- Gërmim kanali me mikrotunel me makineri me drejtim lazer.

Ky është një nga zërat më specifikë të preventivit dhe kërkon domosdoshmërisht disponimin e kësaj makinerie.

MAKINERITË E ASFALTIMIT

19. Autobitumatriçe – 1 copë

20. Asfaltoshtuese – 1 copë

21. Prerëse/Sharrë Asfalti – 1 copë

Këto makineri lidhen me:

- Prerje asfalti 950 ml;
- Binder 1,651 m²;
- Asfaltobeton 4,980 m².

Për realizimin cilësor të rikonstruksionit rrugor pas mbylljes së kanaleve, këto pajisje janë të domosdoshme.

PAJISJET E ZBATIMIT TË PUNIMEVE

22. Vibrator – 1 copë

Kërkohet për ngjeshjen dhe eliminimin e boshllëqeve në beton gjatë realizimit të strukturave betonarme.

23. Tokmak elektrik – 1 copë

Lidhet drejtpërdrejt me zërin:

- Mbushje, rafshim dhe ngjeshje me tokmak elektrik.

Është pajisje e parashikuar specifikisht në preventiv.

24. Matrapik – 1 copë

Kërkohet për prishje lokale të betonit, bordurave dhe elementeve ekzistuese.

25. Gjenerator – 1 copë

Nevojitet për furnizimin me energji të pajisjeve në zonat ku nuk ka akses të drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik.

26. Kontenier për zyrë stacionere – 1 copë

Shërben si bazë administrative dhe teknike e kantierit gjatë afatit 12-mujor të kontratës.

PAJISJET SPECIALE PËR RRJETIN HDPE DHE TRENCH BOX

27. Aparaturë për bashkim tubacionesh – 1 copë

Lidhet drejtpërdrejt me montimin e tubacioneve HDPE DN 250 mm deri DN 630 mm dhe është e domosdoshme për realizimin e nyjeve sipas standardeve teknike.

28. Batipal manual për montim panelesh metalik – 2 copë

29. Mjet për batipal – 1 copë

Kërkohen për montimin dhe çmontimin e sistemit të mbrojtjes së gjurmëve "Trench Box", i cili përdoret në mbi 3,111 ml gjurmë të parashikuara në preventiv.

Përfundimisht, të gjitha makineritë dhe pajisjet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit, me volumn e konsiderueshëm të punimeve, me specialistët teknikë të

kërkuar për realizimin e kontratës dhe me afatin 12-mujor të zbatimit, duke përbërë kapacitetin minimal teknik të nevojshëm për përmbushjen me sukses të objektit të prokurimit.

Në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si dhe kërkesave të Udhëzimit për masat e sigurisë dhe shëndetit gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar pajisjet minimale të sigurisë dhe mbrojtjes në punë që duhet të disponojë operatori ekonomik për realizimin e objektit “Rehabilitimi i Kolektorëve të K.U.Z në Qytetin e Kukësit”.

Kuti e Ndhmës së Shpejtë – 5 copë

Referuar nenit 23 të Ligjit nr.10237/2010 dhe kërkesave të VKM nr.312/2010, çdo kantier ndërtimi duhet të jetë i pajisur me mjete të ndihmës së parë për përballimin e rasteve emergjente dhe dhënien e ndihmës së menjëhershme në rast aksidenti.

Duke qenë se objekti parashikon: përdorimin e makinerive të rënda; punime në gjurmime dhe kanale; punime me materiale betoni dhe asfalti; angazhimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish;

Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i 5 kutive të ndihmës së shpejtë është i nevojshëm për shpërndarjen e tyre në disa pika pune njëkohësisht dhe për garantimin e reagimit të menjëhershëm në rast emergjence.

2. Tabela Sinjalistike të Përkohshme për Menaxhimin e Trafikut – 10 copë

Punimet zhvillohen përgjatë akseve rrugore urbane ekzistuese, ku preventivi parashikon: prerje asfalti 950 ml; gjurmime lineare për kolektorët; rikonstruksion të trotuareve; asfaltim dhe rikthim të shtresave rrugore.

Referuar VKM nr.312/2010 dhe kërkesave të sigurisë në kantier, zonat e punës duhet të sinjalizohen në mënyrë të qartë për përdoruesit e rrugës dhe për punonjësit.

Tabela sinjalistike janë të nevojshme për: devijimin e trafikut; kufizimin e aksesit në zonat e gjurmimit; paralajmërimin e përdoruesve të rrugës; mbrojtjen e punonjësve gjatë kryerjes së punimeve.

Numri prej 10 tabelash është proporcional me gjatësinë e konsiderueshme të traseve të kolektorëve dhe me nevojën për organizimin e sigurt të trafikut në disa segmente pune.

Helmeta Pune (Kokore) – 40 copë

Referuar Ligjit nr.10237/2010 dhe VKM nr.312/2010, përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse është i detyrueshëm për çdo punëmarrës që operon në kantier ndërtimi.

Në objekt janë kërkuar: drejtues teknikë; staf inxhinierik; teknikë; punonjës të specializuar; operatorë makinerish; punëtorë të thjeshtë, si dhe është kërkuar disponimi i minimumi 40 punonjësve për realizimin e kontratës.

Fikëse Zjarri të Lëvizshme – 3 copë

Referuar VKM nr.312/2010, çdo kantier ndërtimi duhet të jetë i pajisur me mjete për parandalimin dhe ndërhyrjen në rast zjarri.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë **Grafikun e punimeve** në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 258/2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).**

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", Pika 5 ku parashikohet: *"Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Njesia e Prokurimit :